



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu, 60000, Gjiilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Ref. nr. 01/2024 / Dt. 08/12 /2020

Në bazë të nenit 49 paragrafi 1 nen paragrafi 1.3 dhe 1.4, të statutit të Universiteti Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan, nenit 7 dhe 8 të Rregullores për procedurat e sigurimit të cilësisë në UKZ, Ref. nr. 01/380, të datës 10.05.2016, Senati i UKZ-së, në mbledhjen e mbajtur me datë 07.12.2020, nxjerrë:

R R E G U L L O R E

Për themelimin dhe funksionimin e Këshillit për mbikëqyrjen e cilësisë dhe për vlerësim (më tej KMCV)

Neni 1

Përkufizimi

KMCV është organ këshillues i Senatit dhe Rektorit, i cili në bashkëpunim me organe të tjera mbështetëse dhe profesionale të Universitetit, si Zyra për cilësi e zhvillim akademik dhe Zyra për çështje akademike, planifikon, monitoron, analizon dhe administron procedurat e vlerësimit të procesit mësimor, hulumtimit shkencor, kërkimit artistik dhe gjitha vlerësimet e fushave të tjera që mbulohen nga universiteti.

Neni 2

KMCV e themelon Senati i UKZ, me propozim të rektorit dhe Zyrës për Cilësi.

Anëtarë të KMCV janë:

1. Prorektori për çështje mësimore dhe të studentëve
2. Prodekani për çështje mësimore prej secilës njësi akademike
3. Drejtori i Zyrës për Cilësi dhe zhvillim akademik
4. Drejtori i Zyrës për çështje akademike
5. Dy studentë, me sukses të shkëlqyeshëm.

Mandati i KMCV është katër (4) vjeçar. Për studentët është dy (2) vjeçar.

Anëtarët e KMCV mund të ndërrohen e të zëvendësohen, në të njëjtën mënyrë si janë emëruar.

Neni 3

Detyrat e Këshillit të Menaxhimit të Cilësisë së janë:

1. I propozon Rektorit dhe Senatit një strategji me udhëzimet e sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit, kriteret, standardet dhe procedurat për realizimin e saj dhe përmirësimin e vazhdueshëm;
2. Harton Manualin e Sigurimit të Cilësisë;
3. Harton dhe aprovon planin e aktiviteteve për sigurimin e cilësisë në përputhje me rregullativën në fuqi dhe dokumentet strategjike të UKZ;
4. I dorëzon Rektorit dhe Senatit raport mbi planin e realizuar në aspektin e Sigurimit të cilësisë;
5. I jep sugjerime Rektorit, Senatit, Këshillave të njësive akademike, për përmirësim të nivelit të cilësisë;
6. Inkurajon diskutimet për cilësinë dhe promovon kulturën e cilësisë brenda universitetit;
7. Analizon të dhënat e mbledhura nga fushat e nenit 2 të kësaj Rregullore;
8. Harton dhe i propozon Senatit aprovimin e raportit e vetëvlerësimit për Ri/Akreditim Institucional;
9. Këshillon Senatit dhe Këshillat e njësive akademike për aprovimin e raporteve të vetëvlerësimit për Ri/Akreditim të Programeve të Studimit;
10. Në bashkëpunim me menaxhmentin e lartë dhe dekanët zgjedhë anëtarët e komisioneve ad-hoc për realizimin e vlerësimeve sipas nevojës;
11. Harton raporte të përmirësimit në bazë të të dhënave dhe vlerësimeve të pranuar nga Departamenti për Vlerësim dhe Sigurim të Cilësisë;
12. Harton raporte të përmirësimit në bazë të vlerësimeve të Komisioneve ad hoc, të cilat bëjnë vlerësim të brendshëm periodik të programeve aktuale të studimit, dhe ia paraqet Këshillit të Njësive Akademike dhe Menaxhmentit të Lartë;
13. Analizon dhe aprovon raportet periodike/vjetore dhe planet e veprimitarisë së sistemit të sigurimit të cilësisë së njësive akademike të Universitetit, të cilat raporte i dërgon te Menaxhmenti i Lartë.

Kryesuesi i Senatit



Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi, rektor

